INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 2/87
Dt. 30.10.2026
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA / VLADA / GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISË
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
Njësia Org. / Org. Jedin / Org. Unit: 013
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 2105/1
Data / Datum / Date: 03.11.26
PRISHTINË A NO.1

INFRAKOS SH.A

NDËRMARRJA PUBLIKE
INFRASTRUKTURA E HEKURUDHAVE TË KOSOVËS - INFRAKOS SH.A
Adresa: "Sheshi Lirisë" nr. 36 Fushë Kosovë tel. +383 38 550 550 500 www.infrakos.com

Në mbështetje të nenit 30, paragrafi 30.1, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 05/L-009 dhe Ligjit nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike, ndërlidhur me nenin 26.15 të Kodit të Etikës për Qeverisjen Korporative, si dhe nenin 15 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - INFRAKOS SH.A., Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2026, merr këtë:

V E N D I M

I. Miratohet Plani i Biznesit i Ndërmarrjes Publike "Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës - Infrakos SH.A. për vitin 2027.

II. Obligohet Menaxhmenti i Ndërmarrjes që të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për zbatimin e Planit të Biznesit të miratuar sipas pikës I të këtij Vendimi.

III. Obligohet Sekretari i ndërmarrjes që Planin e Biznesit për vitin 2027 sipas pikës I të këtij vendimi ta procedojë në NJPMNP-ME.

IV. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

INFRAKOS SH.A. - INFRAKOS D.D. - INFRAKOS J.S.C. Fushë Kosovë

Z. Getuar Zogu

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
N.P. Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës
INFRAKOS SH.A.

I dërgohet:

Bordit të Drejtorëve
Kryeshefit Ekzekutiv
Sekretarit
NJPMNP - ME
Arkivit të ndërmarrjes

Infrakos

INFRAKOS SH.A.
INFRAKOS D.D.
INFRAKOS J.S.C.
2
Nr.No.Br. 02/87-1
Dt. 30.10.2027
Fushë Kosovë - Fushe Kos

INFRAKOS SH. A.

PLANI I BIZNESIT 2027

Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, "INFRAKOS"SH.A



www.infrakos.com, Tel: 00383 (0) 38 550 550, Fushë Kosovë, Sheshi i Lirisë p.n

BAZA LIGJORE E HARTIMIT TË PLANIT TË BIZNESIT

Plani i Biznesit i INFRAKOS-it për vitin 2027 është hartuar në përputhje me Nenin 30 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111, si dhe në pajtim me Statutin e INFRAKOS-it dhe aktet e tjera përkatëse në fuqi.

Parathënie

Rrjeti hekurudhor i Kosovës, i menaxhuar nga INFRAKOS, përbën një infrastrukturë me rëndësi për zhvillimin e transportit hekurudhor dhe ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe efikase për operatorët hekurudhorë. Pavarësisht procesit të vazhdueshëm të rehabilitimit të infrastrukturës dhe sfidave të tjera, INFRAKOS siguron në mënyrë të vazhdueshme, menaxhimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, si dhe ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me të.


Gjatë vitit 2027, siguria hekurudhore, mirëmbajtja e rregullt e infrastrukturës, menaxhimi efikas i aseteve dhe përmirësimi i gjendjes teknike të rrjetit do të mbeten ndër prioritetet kryesore të INFRAKOS-it. Njëkohësisht, kompania do të fokusohet në rritjen e efikasitetit operacional, uljen e shpenzimeve, zvogëlimin e detyrimeve financiare dhe përmirësimin e nivelit të inkasimit.

Plani i Biznesit për vitin 2027 është hartuar duke marrë parasysh kapacitetet dhe nevojat aktuale të ndërmarrjes, prioritetet e sektorit hekurudhor dhe objektivat e përcaktuara në kuadrin strategjik të INFRAKOS-it. Ai synon të krijojë një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm të ndërmarrjes, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe përdorimin sa më efikas të kapaciteteve ekzistuese.

Një rëndësi e veçantë në këtë drejtim i kushtohet rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës hekurudhore, përfshirë projektet prioritare të zhvillimit, si dhe krijimit të kushteve për rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të rrjetit. Realizimi i këtyre objektivave kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet publike, operatorët hekurudhorë dhe partnerët zhvillimorë, si dhe sigurimin e burimeve të nevojshme financiare.

INFRAKOS do të vazhdojë të punojë në forcimin e përgjegjësisë institucionale, profesionalizimin e stafit, përmirësimin e proceseve të punës dhe përdorimin e zgjidhjeve teknologjike dhe inovative. Në të njëjtën kohë, ndërmarrja synon të ruajë dhe të rrisë besimin e përdoruesve, partnerëve dhe palëve të tjera të interesit përmes transparencës, efikasitetit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore.

Kryeshefi Ekzekutiv
Bujar JUPAJ



Deklarata e drejtimit strategjik

Përmbajtja:

KAPITULLI I – DREJTIMI STRATEGJIK, OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET 5
1.1 Vizioni 5
1.2 Misioni 5
1.3 Vlerat dhe parimet e INFRAKOS-it 5
1.4 Historiku dhe gjendja aktuale e infrastrukturës hekurudhore 5
1.5 Mjedisi dhe ndikimi në zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore 6
1.6 Mundësitë dhe reflektimi i tyre në Planin e Biznesit 7
1.7 Objektivat dhe prioritetet e INFRAKOS-it për vitin 2027 7
1.8 Kapacitetet profesionale dhe potenciali i stafit për realizimin e objektivave 8
1.9 Kushtet dhe kërkesat për realizimin e objektivave 9
1.10 Raportimi, monitorimi dhe llogaridhënia 10
KAPITULLI II – SIGURIA HEKURUDHORE 12
2.1 Siguria hekurudhore 12
2.2 Përmirësimi dhe forcimi i sigurisë hekurudhore 12
2.3 Aksidentet dhe incidentet hekurudhore 12
2.4 Rreziqet në vendkalimet rrugë–hekurudhë 12
KAPITULLI III – QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE DHE ORGANIZATIVE 14
3.1 Qëndrueshmëria financiare 14
3.2 Qëndrueshmëria organizative 14
KAPITULLI IV – ASETET DHE KAPACITETET E INFRASTRUKTURËS 15
4.1 Menaxhimi i aseteve 15
4.2 Kapacitetet dhe performanca e rrjetit hekurudhor 16
KAPITULLI V – PROJEKTET ZHVILLIMORE 17
5.1 Projektet zhvillimore 17
5.2 Projektet e financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës 17
5.3 Projektet zhvillimore të financuara nga grandet dhe kredit 17
KAPITULLI VI – ORGANIZIMI, TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI 20
6.1 Ndryshimet organizative 20
6.2 Teknologjia dhe inovacionet 20
6.3 Analiza SWOT 21
KAPITULLI VII – ANALIZA STRATEGJIKE DHE FINANCIARE 23
7.1 Analiza financiare, të hyrat dhe financimi 23
7.2 Shpenzimet 24
7.3 Analiza e riskut financiar dhe operacional 24
7.4 Monitorimi i realizimit dhe kontributi në arritjen e objektivave 25
KAPITULLI VIII – ZBATIMI DHE MONITORIMI 27

8.1 Programi i aktiviteteve dhe monitorimi i zbatimit 27
8.2 Supozimet kyçe dhe kushtet e realizimit 27
8.3 Vlerësimi i rreziqeve 28
KAPITULLI IX – BURIMET NJERËZORE 31
9.1 Struktura organizative e kompanisë 31
9.2 Resurset njerëzore dhe planifikimi afatgjatë 31
9.3 Politikat e punësimit 32
KAPITULLI X – PERSPEKTIVA AFATGJATË DHE SFIDAT 34
10.1 Rëndësia strategjike e transportit hekurudhor 34
10.2 Sfidat kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2027 34
10.3 Perspektiva e zhvillimit të rrjetit hekurudhor 36
KAPITULLI XI – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE MIRATIMI 37

KAPITULLI I – DREJTIMI STRATEGJIK, OBJEKTIVAT DHE PRIORITETET

1.1 Vizioni

Të jemi prijës në ofrimin e kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe shërbimeve të ndërlidhura me të për të gjithë operatorët e transportit hekurudhor, brenda dhe jashtë vendit, në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese. Të jemi ofrues tërheqës dhe efikas të rrjetit hekurudhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të transportit dhe ekonomisë së Kosovës e më gjerë, si dhe duke përmbushur kërkesat e sigurisë, mbrojtjes së mjedisit dhe efikasitetit ekonomik.

1.2 Misioni

Misioni i INFRAKOS-it është mirëmbajtja, rehabilitimi, modernizimi dhe zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore, me qëllim garantimin e sigurisë, funksionalitetit dhe qëndrueshmërisë së rrjetit hekurudhor dhe qarkullimit të sigurt të trenave të udhëtarëve dhe mallrave.

INFRAKOS-i siguron kushte për shfrytëzimin efikas të kapaciteteve të infrastrukturës nga operatorët hekurudhorë, në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese, duke respektuar kërkesat e sigurisë hekurudhore, mbrojtjes së mjedisit dhe efikasitetit ekonomik.

Në përmbushje të misionit të tij, INFRAKOS-i vepron në funksion të interesit publik dhe përmbush obligimet që burojnë nga kërkesat e taksapaguesve të Republikës së Kosovës dhe institucioneve përkatëse qeveritare.

1.3 Vlerat dhe parimet e INFRAKOS-it

INFRAKOS-i, si kompani përgjegjëse për menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore në Republikën e Kosovës, do të udhëhiqet nga këto vlera dhe parime:

- Ofrimi i kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore për të gjithë operatorët hekurudhorë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi dhe parimet e korrektësisë, barazisë, transparencës dhe jodiskriminimit.
- Ofrimi i shërbimeve infrastrukturore në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese për të gjithë operatorët hekurudhorë.
- Administrimi dhe shfrytëzimi efikas i patundshmërive të kompanisë, duke garantuar trajtim të barabartë dhe transparent për klientët ekzistues dhe potencialë.
- Garantimi i nivelit më të lartë të mundshëm të sigurisë së qarkullimit të trenave të udhëtarëve dhe mallrave në tërë rrjetin hekurudhor.
- Bashkëpunimi me institucionet qendrore dhe lokale, operatorët hekurudhorë dhe komunitetin, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

1.4 Historiku dhe gjendja aktuale e infrastrukturës hekurudhore

INFRAKOS ka në menaxhim të drejtpërdrejtë rrjetin hekurudhor të Republikës së Kosovës, i cili shtrihet në territorin e vendit me një gjatësi të përgjithshme prej rreth 335 kilometrash. Që nga fillimi i ndërtimit të linjës së parë hekurudhore në vitin 1874 e deri më sot, infrastruktura hekurudhore në Kosovë ka kaluar nëpër sfida të shumta, si në aspektin e mirëmbajtjes dhe zhvillimit teknik, ashtu edhe në atë të shfrytëzimit operacional të linjave.

Gjatë viteve të kaluara, gjendja teknike e infrastrukturës është ndikuar nga nevoja e vazhdueshme për investime kapitale, rehabilitimin e linjave ekzistuese dhe kufizimet financiare për realizimin e projekteve të nevojshme. Këta faktorë kanë ndikuar drejtpërdrejt në mundësitë e shfrytëzimit të rrjetit hekurudhor dhe në kapacitetin e INFRAKOS-it për ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe cilësore.



Gjatë vitit 2026, INFRAKOS-i ka pasur në shfrytëzim operacional linjën hekurudhore Prishtinë – Fushë Kosovë – Pejë dhe linjën Bardh – Medvec, ndërsa linjat Prishtinë – Podujevë, Klinë – Prizren dhe Leshak – Mitrovicë kanë qenë jashtë operimit. Linja strategjike Mitrovicë – Hani i Elezit ka qenë jashtë operimit për shkak të punimeve të rehabilitimit të përgjithshëm.

Për vitin 2027, INFRAKOS-i parasheh vazhdimin dhe avancimin e proceseve të rehabilitimit dhe zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore, me fokus të veçantë në përfundimin e punimeve të rehabilitimit të Linjës 10 dhe krijimin e kushteve për vënien në funksion të segmenteve të rehabilituara, në përputhje me kërkesat teknike dhe të sigurisë. Në këtë kuadër, zhvillimi i mëtejshëm i rrjetit dhe përgatitja e projekteve të reja do të trajtohen në përputhje me prioritetet strategjike dhe mundësitë e financimit.

1.5 Mjedisi dhe ndikimi në zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore

Infrastruktura hekurudhore përfaqëson një komponent të rëndësishëm të sistemit të transportit në Kosovë dhe ofron shërbime për tregje dhe kategori të ndryshme të përdoruesve. Përmbushja e kërkesave të tyre për shërbime cilësore, të sigurta dhe ekonomikisht të qëndrueshme kërkon politika dhe strategji të qarta zhvillimore, si dhe mbështetje të qëndrueshme institucionale.

Për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore është e domosdoshme që politikat qeveritare të orientohen drejt investimeve dhe mirëmbajtjes afatgjatë të rrjetit, në mënyrë që infrastruktura të ofrojë kushte të përshtatshme, kapacitet, cilësi dhe siguri. Në këtë kuadër, realizimi i projekteve të rehabilitimit dhe modernizimit të rrjetit mbetet një parakusht i rëndësishëm për rritjen e përdorimit të kapaciteteve hekurudhore dhe për përmirësimin e shërbimeve infrastrukturore.

Në të njëjtën kohë, zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore duhet të marrë parasysh mbrojtjen e mjedisit, përdorimin racional të burimeve dhe rritjen e rolit të transportit hekurudhor si alternativë e qëndrueshme ndaj transportit rrugor.

INFRAKOS-i, në ushtrimin e përgjegjësive që ka, do të vazhdojë të fokusohet në ofrimin e shërbimeve infrastrukturore në mënyrë të sigurt, transparente, të barabartë dhe jodiskriminuese, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse dhe palët e interesit për zhvillimin e qëndrueshëm të rrjetit hekurudhor.

1.6 Mundësitë dhe reflektimi i tyre në Planin e Biznesit

Mundësitë për mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore janë të rëndësishme për realizimin e objektivave strategjike të INFRAKOS-it dhe për rritjen e rolit të transportit hekurudhor në Kosovë. Plani i Biznesit për vitin 2027 është hartuar duke u bazuar në nevojat reale të kompanisë, gjendjen e infrastrukturës dhe mundësitë e zhvillimit dhe financimit të projekteve prioritare.

Në këtë kuadër, Plani përcakton nevojat dhe prioritetet kryesore të INFRAKOS-it për mirëmbajtjen e rrjetit, rehabilitimin dhe modernizimin e infrastrukturës, si dhe për përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve infrastrukturore. Realizimi i këtyre prioriteteve kërkon sigurimin dhe orientimin e burimeve financiare në përputhje me nevojat dhe mundësitë e kompanisë.

INFRAKOS-i synon realizimin e investimeve dhe mbështetjes financiare të parapara në kuadër të strategjisë zhvillimore të sektorit hekurudhor dhe legjislacionit në fuqi, duke përfshirë mbështetjen nga institucionet vendore dhe partnerët zhvillimorë, sipas programeve dhe marrëveshjeve përkatëse.

Për këtë qëllim, Plani i Biznesit për vitin 2027 përcakton nevojat, kërkesat dhe prioritetet e INFRAKOS-it dhe orienton burimet dhe veprimet e kompanisë drejt realizimit të tyre, duke synuar një rrjet hekurudhor më të sigurt, funksional dhe të qëndrueshëm.

1.7 Objektivat dhe prioritetet e INFRAKOS-it për vitin 2027

Në mbështetje të vizionit dhe misionit të INFRAKOS-it, për vitin 2027 përcaktohen objektiva dhe prioritete që synojnë rritjen e sigurisë, përmirësimin e mirëmbajtjes, forcimin e kapaciteteve profesionale, qëndrueshmërinë financiare dhe menaxhimin efikas të aseteve, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të infrastrukturës hekurudhore.

INFRAKOS-i e konsideron vitin 2027 si vit të konsolidimit të rezultateve, rritjes së sigurisë dhe përmirësimit të qëndrueshëm të performancës së kompanisë. Në këtë kuadër, prioritetet kryesore janë:

1. **Siguria dhe mirëmbajtja e infrastrukturës**
   Garantimi i sigurisë së punonjësve, udhëtarëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion përmes mirëmbajtjes së rregullt të infrastrukturës, identifikimit të hershëm dhe trajtimit efikas të rreziqeve, si dhe inspektimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të gjendjes teknike të rrjetit.
2. **Zhvillimi i kapaciteteve profesionale**
   Ngritja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve profesionale të stafit, me fokus në sigurinë në punë, profesionalizimin dhe përmirësimin e performancës.
3. **Qëndrueshmëria financiare dhe menaxhimi i burimeve**
   Menaxhimi racional i shpenzimeve dhe burimeve, rritja e të hyrave dhe përmirësimi i inkasimit, si dhe administrimi më efikas i aseteve dhe patundshmërive të kompanisë.
4. **Qasja transparente dhe jodiskriminuese në infrastrukturë**
   Ofrimi i qasjes në rrjet dhe kapaciteteve të infrastrukturës për operatorët hekurudhorë në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat në fuqi.
5. **Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës**
   Vazhdimi i rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës 10 Hekurudhore, në përputhje me statusin teknik, kërkesat e sigurisë dhe financimin e konfirmuar, si dhe avancimi i projekteve

të linjave dhe Fushë Kosovë–Klinë–Pejë dhe Klinë–Prizren dhe projekte tjera në përputhje me burimet e financimit.

6. **Bashkëpunimi institucional dhe zhvillimor**
   Forcimi i bashkëpunimit me institucionet vendore, partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet financiare zhvillimore, me qëllim sigurimin e mbështetjes dhe avancimin e projekteve për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.

Qëllimi ynë	Të sigurojmë menaxhimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore, duke garantuar siguri, funksionalitet dhe ofrim të barabartë të kapaciteteve për operatorët hekurudhorë.
Roli i ynë	Të kontribuojmë në zhvillimin e transportit hekurudhor në Kosovë përmes menaxhimit efikas të infrastrukturës, rritjes së sigurisë dhe krijimit të kushteve për shfrytëzim më të madh të rrjetit hekurudhor.
Çfarë synojmë	Të realizojmë objektivat dhe prioritetet e përcaktuara për vitin 2027, me fokus në siguri dhe mirëmbajtje, kapacitete profesionale, qëndrueshmëri financiare, menaxhim të aseteve, rehabilitim dhe modernizim të infrastrukturës, si dhe bashkëpunim institucional.
Si do t'i realizojmë	Përmes planifikimit dhe menaxhimit të përgjegjshëm të burimeve, angazhimit të stafit, mirëmbajtjes parandaluese, monitorimit të performancës, identifikimit dhe trajtimit të rreziqeve, si dhe koordinimit të vazhdueshëm me institucionet dhe partnerët financiarë e zhvillimorë.


1.8 Kapacitetet profesionale dhe potenciali i stafit për realizimin e objektivave

INFRAKOS-i disponon përvojë shumëvjeçare dhe kapacitete profesionale në menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore. Përvoja e akumuluar ndër vite dhe angazhimi i stafit përbëjnë një bazë të rëndësishme për përmbushjen e përgjegjësive ligjore të kompanisë dhe realizimin e objektivave të përcaktuara për vitin 2027.

Për realizimin e objektivave të vitit 2027, INFRAKOS-i do të fokusohet në ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale, përmes trajnimeve dhe ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve teknike dhe profesionale. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ruajtjes dhe transferimit të njohurive profesionale, duke marrë parasysh specifikat teknike të veprimtarisë hekurudhore dhe nevojën për personel të kualifikuar.

Një nga kushtet e rëndësishme për realizimin e objektivave është sigurimi i burimeve të nevojshme financiare. Gjendja financiare e kompanisë dhe specifikat e sektorit hekurudhor kërkojnë planifikim realist, përcaktim të qartë të prioriteteve dhe mbështetje të qëndrueshme financiare.

Realizimi i plotë i objektivave të INFRAKOS-it për vitin 2027 ndërlidhet edhe me zbatimin e Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare me Qeverinë e Republikës së Kosovës. Sigurimi i kësaj mbështetjeje është i rëndësishëm për ruajtjen e kapaciteteve profesionale dhe për realizimin e prioriteteve të kompanisë në fushën e mirëmbajtjes, sigurisë dhe zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.



1.9 Kushtet dhe kërkesat për realizimin e objektivave

Për realizimin e objektivave të përcaktuara për vitin 2027, INFRAKOS-i duhet të sigurojë kushte të përshtatshme financiare, organizative dhe profesionale, si dhe bashkëpunim të qëndrueshëm me institucionet përgjegjëse dhe partnerët zhvillimorë. Kërkesat kryesore lidhen me sigurinë hekurudhore, qëndrueshmërinë e kompanisë, menaxhimin e aseteve, përmirësimin e performancës dhe realizimin e projekteve prioritare.

Siguria hekurudhore	NFRAKOS-i do të fokusohet në mirëmbajtjen e rregullt dhe parandaluese të infrastrukturës, identifikimin dhe eliminimin në kohë të faktorëve që mund të cenojnë sigurinë hekurudhore, si dhe në përmbushjen e kërkesave teknike dhe të sigurisë. Për realizimin e këtyre prioriteteve, kompania do të vazhdojë të adresojë nevojat për mbështetje institucionale dhe financiare tek institucionet përgjegjëse.
Qëndrueshmëria	INFRAKOS-i do të synojë forcimin e qëndrueshmërisë financiare dhe teknike përmes planifikimit të përgjegjshëm të burimeve, menaxhimit efikas të shpenzimeve dhe bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse dhe partnerët zhvillimorë, me qëllim sigurimin e kushteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.
Asetet	INFRAKOS-i do të synojë menaxhimin efikas të aseteve dhe patundshmërive, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre racional, si dhe vlerësimin e potencialit të tyre për të kontribuar në zhvillimin e kompanisë dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare, në përputhje me planet dhe prioritetet strategjike.
Performanca	INFRAKOS-i do të fokusohet në menaxhimin efikas të rrjetit dhe kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore, në mënyrë që operatorëve hekurudhorë t'u ofrohen kapacitete të sigurta, të disponueshme dhe në përputhje me kërkesat dhe rregullat në fuqi, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së kompanisë.
Projektet	INFRAKOS-i do të fokusohet në menaxhimin dhe realizimin e projekteve të planifikuara dhe të financuara, me vëmendje të veçantë në projektet e

mbështetura nga Buxheti i Kosovës dhe partnerët zhvillimorë. Për këtë qëllim, kompania do të përcaktojë nevojat, prioritetet dhe kërkesat për financim dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe partnerët përkatës për avancimin e projekteve deri në realizimin e tyre

1.10 Raportimi, monitorimi dhe llogaridhënia


INFRAKOS-i do të vazhdojë të zbatojë me përpikëri detyrimet për informim dhe raportim ndaj institucioneve përgjegjëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet përkatëse të kompanisë.

Raportimi do të mbështetet në të dhëna të sakta, të plota dhe të verifikueshme, me qëllim që të sigurohet pasqyrë transparente mbi gjendjen e kompanisë, realizimin e objektivave dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.



Monitorimi i realizimit të Planit të Biznesit do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2027, nëpërmjet përcjelljes së aktiviteteve dhe rezultateve të përcaktuara për njësitë organizative përgjegjëse. Në rast të devijimeve nga objektivat e planifikuara, do të ndërmerren masat e nevojshme korrigjuese. Menaxhmenti dhe njësitë organizative përgjegjëse do të jenë të obliguara të raportojnë për nivelin e realizimit të aktiviteteve, rezultatet e arritura dhe pengesat eventuale që mund të ndikojnë në zbatimin e Planit të Biznesit.

Në këtë mënyrë, raportimi, monitorimi dhe llogaridhënia do të shërbejnë si mekanizma për rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë dhe efektivitetit në realizimin e objektivave të INFRAKOS-it për vitin 2027.



Transformimi i rrjetit hekurudhor

KAPITULLI II – SIGURIA HEKURUDHORE

2.1 Siguria hekurudhore

Siguria e punonjësve, udhëtarëve dhe e të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në komunikacion mbetet prioriteti kryesor i INFRAKOS-it për vitin 2027. Për arritjen e këtij qëllimi, kompania do të fokusohet në mirëmbajtjen e infrastrukturës, identifikimin e hershëm dhe trajtimin efikas të rreziqeve potenciale, përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes teknike të pajisjeve dhe mjeteve të punës, si dhe në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve profesionale të stafit.

Siguria hekurudhore do të mbështetet në zbatimin e kërkesave teknike dhe të procedurave të sigurisë, mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës dhe pajisjeve, inspektimin e gjendjes së rrjetit dhe përcaktimin e qartë të përgjegjësive në të gjitha nivelet organizative.

2.2 Përmirësimi dhe forcimi i sigurisë hekurudhore

Gjatë vitit 2027, INFRAKOS-i do të përqendrojë aktivitetet e tij në mirëmbajtjen e rregullt dhe të linjave hekurudhore dhe pajisjeve teknike, identifikimin dhe eliminimin e faktorëve që mund të ndikojnë në sigurinë e qarkullimit hekurudhor, si dhe në monitorimin e vazhdueshëm të gjendjes së infrastrukturës.

Në këtë kuadër, rëndësi do t'i kushtohet edhe gjendjes teknike të sistemeve sinjalizuese, telekomunikuese dhe energjetike, si dhe organizimit dhe mbikëqyrjes së sigurt të qarkullimit të trenave.

Përmirësimi i sigurisë do të mbështetet edhe në zhvillimin profesional të stafit, zbatimin e procedurave përkatëse dhe forcimin e përgjegjësisë dhe llogaridhënies në ushtrimin e detyrave. Kjo qasje është në përputhje me prioritetet e përcaktuara për vitin 2027.

2.3 Aksidentet dhe incidentet hekurudhore

INFRAKOS-i do të monitorojë ngjarjet, incidentet dhe aksidentet që lidhen me infrastrukturën hekurudhore, do të analizojë shkaqet dhe faktorët kontribues dhe brenda fushëveprimit dhe përgjegjësive të tij ligjore, do të ndërmarrë masa parandaluese dhe korrigjuese.

Të dhënat për aksidentet dhe incidentet do të trajtohen në bazë të evidencave zyrtare dhe të verifikuara, duke bërë dallimin ndërmjet llojit të ngjarjes, pasojave dhe faktorëve që kanë ndikuar në të. Trajnimi i vazhdueshëm i stafit, zbatimi i procedurave të sigurisë dhe përcaktimi i qartë i përgjegjësive do të jenë pjesë e rëndësishme e këtij procesi.

2.4 Rreziqet në vendkalimet rrugë–hekurudhë

Vendkalimet në nivel rrugë–hekurudhë mbeten një nga fushat me rëndësi të veçantë për sigurinë e komunikacionit. Numri i vendkalimeve të pambrojtura dhe sjellja e pjesëmarrësve në komunikacion paraqesin rrezik potencial për sigurinë, veçanërisht në rastet kur nuk respektohen shenjat dhe rregullat e komunikacionit. Duke marrë parasysh numrin e konsiderueshëm të vendkalimeve në nivel rrugë–hekurudhë që nuk janë të pajisura me sisteme mbrojtëse, si dhe kostot që kërkon pajisja e tyre, INFRAKOS-i do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet kompetente për identifikimin e masave të nevojshme dhe koordinimin e veprimeve për rritjen e sigurisë në këto vendkalime, në përputhje me kompetencat e secilit institucion.



Një shqetësim të veçantë paraqesin edhe vendkalimet ilegale, të cilat cenojnë sigurinë e komunikacionit. Me identifikimin e tyre, ekipet e INFRAKOS-it do të ndërmarrin masa për eliminimin e tyre, ndërsa për vendkalimet e krijuara pa konsultim paraprak me kompaninë do të vazhdohet adresimi i kërkesave ndaj institucioneve dhe subjekteve përgjegjëse për marrjen e masave adekuate.

Gjatë vitit 2027, INFRAKOS-i do të intensifikojë edhe aktivitetet edukuese dhe informuese përmes mjeteve të informimit dhe aktiviteteve të sensibilizimit, me qëllim parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në trasenë hekurudhore dhe rritjen e sigurisë së komunikacionit.

KAPITULLI III – QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE DHE ORGANIZATIVE

3.1 Qëndrueshmëria financiare

Qëndrueshmëria financiare dhe organizative përbën një parakusht të rëndësishëm për përmbushjen e përgjegjësive të INFRAKOS-it në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore. Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe përdorimi racional i tyre janë të domosdoshme për garantimin e mirëmbajtjes së rregullt të infrastrukturës dhe të kushteve të sigurta për zhvillimin e komunikacionit hekurudhor.

Për vitin 2027, INFRAKOS-i do të fokusohet në përmirësimin e menaxhimit financiar, rritjen e nivelit të inkasimit, menaxhimin racional të shpenzimeve dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës. Të hyrat kryesore planifikohen nga pagesat për qasje në rrjet, shfrytëzimi i patundshmërive dhe aseteve, shërbimet e tjera të kompanisë, si dhe nga financimi dhe subvencionimi publik, në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjet në fuqi.

Menaxhimi i të hyrave do të shoqërohet me procese të kontraktimit, faturimit dhe inkasimit, si dhe me menaxhimin më efikas të detyrimeve dhe borxheve. Qëllimi është rritja e likuiditetit dhe përdorimi sa më efikas i burimeve dhe aseteve të kompanisë.

Planifikimi financiar për vitin 2027 do të mbështetet në kostot e arsyetuara të mirëmbajtjes, parashikimet reale të të hyrave dhe burimet e konfirmuara të financimit. Zbatimi i marrëveshjeve financiare me institucionet përkatëse do të monitorohet në mënyrë që të vlerësohet nëse fondet e siguruara janë të mjaftueshme për mbulimin e nevojave të kompanisë. Në këtë kuadër, financimi publik mbetet një burim i rëndësishëm për mbulimin e nevojave të infrastrukturës hekurudhore, duke marrë parasysh kostot e mirëmbajtjes dhe nevojat për investime. Të hyrat nga qasja në infrastrukturë, qiratë dhe aktivitetet e tjera të kompanisë do të planifikohen në përputhje me mundësitë reale të realizimit. Projeksionet buxhetore për vitin 2027, paraqesin nje trend pozitiv te rritjes se te hyrave dhe shpenzimeve duke ruajtur dhe siguruar një qëndrueshmëri financiare, disiplinë në menaxhimin e shpenzimeve dhe përmirësim të performancës operative, duke krijuar bazë të përshtatshme për realizimin e objektivave strategjike dhe operative të Ndërmarrjes. Projektsionet e ndermarrjes parashohin nje rezultat përfundimtar pozitiv në raport ne mes te hyrave dhe shpenzimev.

3.2 Qëndrueshmëria organizative

Në aspektin organizativ, INFRAKOS-i do të fokusohet në funksionimin efikas të strukturës së kompanisë, ndarjen e qartë të përgjegjësive, koordinimin ndërmjet njësive organizative dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

Gjatë vitit 2027 do të vlerësohen nevojat për përmirësimin e proceseve të punës dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale. Çdo ndryshim eventual në strukturën organizative do të bazohet në nevojat funksionale të kompanisë, mundësitë financiare dhe kornizën ligjore në fuqi. Qëllimi është shfrytëzimi sa më efikas i burimeve në dispozicion, përmirësimi i koordinimit ndërmjet sektorëve dhe mbështetja e realizimit të objektivave të kompanisë, veçanërisht në fushën e sigurisë, mirëmbajtjes dhe zhvillimit të infrastrukturës hekurudhore.

Në realizimin e objektivave financiare dhe organizative, INFRAKOS-i do të synojë një menaxhim më të përgjegjshëm të burimeve, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe lidhjen e planifikimit financiar me prioritetet reale të kompanisë

KAPITULLI IV – ASETET DHE KAPACITETET E INFRASTRUKTURËS


4.1 Menaxhimi i aseteve

INFRAKOS administron një rrjet të gjerë të infrastrukturës hekurudhore dhe një numër të konsiderueshëm asetesh, të cilat kërkojnë regjistrim, mirëmbajtje dhe menaxhim sistematik.

Për vitin 2027, prioritet do të jetë përmirësimi i evidencës dhe administrimit të aseteve, përmes regjistrimit dhe vlerësimit të tyre, monitorimit të gjendjes fizike dhe përditësimit të të dhënave përkatëse. Kjo do të mundësojë përcaktimin më të saktë të nevojave për mirëmbajtje, planifikimin e investimeve dhe shfrytëzimin më efikas të pronës së ndërmarrjës.

Në këtë drejtim, është iniciuar procedura e prokurimit të avancimit të sistemit informatik për menaxhimin e aseteve, si dhe procedura e prokurimit për vlerësimin e patundshmërive të ndërmarrjes. Pritet që të dy proceset të përfundojnë gjatë muajve të parë të vitit 2027. Realizimi i tyre do të mundësojë administrim më efikas të aseteve, përmirësim të evidencës dhe saktësisë së të dhënave, si dhe mbështetje më të besueshme për vendimmarrjen menaxheriale.

Menaxhimi efikas i aseteve do të kontribuojë në ruajtjen e vlerës së pronës së kompanisë, përmirësimin e planifikimit financiar dhe teknik, si dhe në identifikimin e mundësive për rritjen e të hyrave nga shfrytëzimi i pronës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



4.2 Kapacitetet dhe performanca e rrjetit hekurudhor

Një nga detyrat kryesore të INFRAKOS-it është menaxhimi i kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore dhe ofrimi i qasjes për operatorët e transportit të udhëtarëve dhe mallrave, në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjatë vitit 2025/26, INFRAKOS-i ka realizuar ofrimin e kapaciteteve të nevojshme për operatorët hekurudhorë, përfshirë edhe kërkesat ad hoc për trase shtesë. Linja Fushë Kosovë–Hani i Elezit dhe Fushë Kosovë Mitrovicë nuk është ofruar për shfrytëzim për shkak të punimeve të rehabilitimit.

Gjatë vitit 2027, INFRAKOS-i do të vazhdojë të ofrojë shërbimet e qasjes në rrjet për operatorët e transportit dhe do të jetë i gatshëm të ofrojë kapacitete dhe shërbime edhe për operatorë të tjerë eventualë, në përputhje me kapacitetet teknike dhe rregullat e qasjes në rrjet.

Përmirësimi i menaxhimit të trafikut dhe me planifikimet afatshkurtër e afatgjatë do të synojnë shfrytëzim më efikas të kapaciteteve ekzistuese. Aktualisht, rreth **20% e kapaciteteve ekzistuese** shfrytëzohen nga operatorët hekurudhorë, çka paraqet potencial për rritjen e përdorimit të rrjetit.

Në planifikimin për vitin 2027 do të merret parasysh edhe statusi i linjave që i nënshtrohen rehabilitimit ose që kanë kufizime në qarkullim. Aktivitetet dhe pritshmëritë për këto linja do të përcaktohen në përputhje me gjendjen e punimeve, afatet e konfirmuara dhe mundësitë për vënien e tyre në shfrytëzim.

KAPITULLI V – PROJEKTET ZHVILLIMORE

5.1 Projektet zhvillimore

INFRAKOS-i orienton projektet zhvillimore drejt rehabilitimit, modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës hekurudhore, me qëllim rritjen e sigurisë, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe shfrytëzimin më efikas të kapaciteteve të rrjetit.

Për vitin 2027, prioritetet zhvillimore përcaktohen në bazë të nevojave teknike të infrastrukturës, rëndësisë strategjike të projekteve për sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit, shkallës së gatishmërisë për zbatim dhe mundësive reale të financimit. Në këtë kuadër merren parasysh projektet që janë në realizim, projektet që vazhdojnë pas vitit 2027 dhe projektet prioritare për të cilat ende duhet të sigurohet financimi i plotë.

Realizimi i projekteve zhvillimore varet nga sigurimi i mjeteve financiare nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe burime të tjera vendore e ndërkombëtare, përfshirë institucionet financiare dhe programet përkatëse të mbështetjes, në përputhje me marrëveshjet dhe zotimet e konfirmuara.

5.2 Projektet e financuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës

Për vitin 2027 realizimi i projekteve do të bëhet sipas marrëveshjeve me Ministrin e Ekonomisë dhe Ministria Infrastrukturës dhe Transportit.

5.3 Projektet zhvillimore të financuara nga grandet dhe kredit

Projektet e rehabilitimit të Linjës Hekurudhore 10 përbëjnë ndër projektet kryesore dhe strategjike për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore të Republikës së Kosovës. Ato synojnë përmirësimin e gjendjes teknike të linjës, rritjen e sigurisë dhe krijimin e kushteve më të mira për zhvillimin e transportit hekurudhor vendor dhe ndërkombëtar.

Për vitin 2027, INFRAKOS-i do të përcjellë dhe mbështesë zbatimin e projekteve të rehabilitimit dhe modernizimit të Linjës 10, në bashkëpunim me institucionet dhe partnerët përkatës, me synim përfundimin e punimeve dhe vënien në funksion të infrastrukturës në përputhje me kushtet teknike dhe kërkesat e sigurisë.

Financimi	Emërtimi i projektit	Parashikimet e Kontratës në €	Parashikimet 2027 në €
Projektet të cilat financohen nga kredi dhe grante ndërkombetare BERZH-i, BEI-ja & WBIF	Rehabilitimit gjeneral të linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit – Faza I.	97,378,041.89	13,725,112.00
	Rehabilitimi i linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Mitrovicë – Faza II.	60,103,220.51	15,826,450.00
	Realizimi i Projekt dizajnit detaj teknik për fazën e tretë (Mitrovicë – Leshak)	3,269,000.00	1,969,000.00
	Mbikëqyrja e Projektit të Fazës së Parë	10,628,895.00	721,420.00

	Konsulenca Mbështetëse për Linjën 10 Hekurudhore	823,000.00	589,815.00
Projektet të cilat financohen nga kredi dhe grante ndërkombetare BERZH-i, BEI-ja & WBIF	Rehabilitimin dhe modernizimin e sinjalizimit dhe telekomunikacionit për fazën e parë dhe të dytë të linjës 10-të hekurudhore (Hani Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë)	55,600,000.00	
	Konsulenca mbështetëse për rehabilitimin e linjës 10-të hekurudhore Faza 1, 2 për sinjalizim dhe teklomunikacion	2,189,000.00	

Projektet zhvillimore të financuara nga grandet dhe kredit

Faza I – Fushë Kosovë – Hani i Elezit

Në Fazën I janë realizuar punime të rëndësishme të rehabilitimit të linjës kryesore dhe infrastrukturës përcjellëse. Sipas të dhënave të paraqitura në Plan, janë përfunduar **64.5 km të linjës kryesore, rreth 98.43% e punimeve**. Janë përfunduar binarët në stacione dhe të gjitha tunelet, me përjashtim të tunelit #2 që mbetet në proces ndërtimi. Gjithashtu janë përfunduar **4.5 km gabione, 3 km mbrojtje të pjerrësive, 106 lëshesa, 20 ura prej betoni, 69 ndërrues binarësh dhe 62 km kanale për drenazhimin dhe largimin e ujërave.**

Për vitin 2027, INFRAKOS-i do të përcjellë statusin aktual të projektit dhe do të fokusohet në aktivitetet e mbetura për përfundimin e tij, në përputhje me gjendjen faktike në terren dhe planin e konfirmuar të zbatimit(aktualisht nuk ka nje te tille)

Faza II – Fushë Kosovë – Mitrovicë

Në Fazën II janë përfunduar **31.5 km të linjës kryesore, rreth 91.57% e punimeve,** si dhe **2.2 km binarë në stacione (24.18%), 400 m gabione, 63 lëshesa, 13 ura prej betoni, 4 nënkalime dhe 21 ndërrues binarësh.**

Për vitin 2027, planifikimi do të bazohet në statusin e përditësuar të punimeve, aktivitetet e mbetura dhe afatet e konfirmuara nga palët përgjegjëse, duke pasur parasysh se në materialin bazë nuk është përcaktuar një afat përfundimtar i projektit.

Faza III – Mitrovicë – Leshak dhe komponentët mbështetës

Në kuadër të projekteve zhvillimore është paraparë edhe realizimi i projekt-dizajnit të detajuar teknik për Fazën III **Mitrovicë–Leshak**, si dhe aktivitetet e mbikëqyrjes dhe konsulencës mbështetëse për Linjën 10. Këto aktivitete do të avancohen në përputhje me dokumentacionin teknik dhe mundësitë e konfirmuara të financimit.

Sinjalizimi dhe telekomunikacioni

Një projekt me prioritet për vitin 2027 është **rehabilitimi dhe modernizimi i sistemeve të sinjalizimit dhe telekomunikacionit** për Fazën I dhe Fazën II të Linjës 10, për të cilin në dokument është paraqitur vlera prej **55,600,000 €** dhe parashihet sigurimi i financimit nga BERZH-i, BEI-ja dhe WBIF-i.

Ky projekt ka rëndësi të veçantë për rritjen e nivelit të sigurisë, modernizimin e infrastrukturës teknologjike dhe krijimin e kushteve për funksionim më efikas të Linjës 10.

KAPITULLI VI – ORGANIZIMI, TEKNOLOGJIA DHE INOVACIONI

6.1 Ndryshimet organizative

Gjatë vitit 2027, INFRAKOS-i do të fokusohet në përmirësimin e organizimit të brendshëm dhe forcimin e kapaciteteve profesionale, me qëllim rritjen e efikasitetit në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.

Në këtë kuadër, do të vlerësohen nevojat për përmirësimin e funksionalitetit të njësive organizative, qartësimin e përgjegjësive dhe plotësimin e kapaciteteve njerëzore, përfshirë angazhimin e stafit të ri aty ku paraqitet nevoja. Çdo ndryshim organizativ dhe çdo rekrutim do të trajtohet në përputhje me nevojat e kompanisë, mundësitë financiare dhe kornizën ligjore në fuqi.

Këto veprime synojnë përmirësimin e koordinimit, forcimin e llogaridhënies dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për vitin 2027.

6.2 Teknologjia dhe inovacionet

Modernizimi teknologjik përbën një komponent të rëndësishëm për rritjen e sigurisë, besueshmërisë dhe efikasitetit të infrastrukturës hekurudhore.

Gjatë vitit 2027 do të vazhdojë modernizimi dhe mirëmbajtja e linjave hekurudhore, pajisjeve sinjalizuese dhe siguruese, sistemeve telekomunikuese, pajisjeve për kontrollin e lëvizjes së trenave, si dhe pajisjeve dhe makinerisë për mirëmbajtjen e infrastrukturës.

Në funksion të modernizimit të infrastrukturës, rëndësi të veçantë do t'i kushtohet zhvillimit dhe avancimit të sistemeve të telekomunikimit, sinjalizimit dhe kontrollit të lëvizjes së trenave, si dhe përmirësimit të pajisjeve dhe mjeteve speciale të nevojshme për mirëmbajtjen e rrjetit.

Modernizimi teknologjik do të lidhet ngushtë me rehabilitimin dhe zhvillimin e rrjetit hekurudhor. Në këtë kuadër, do të vazhdohet me përmirësimin e pajisjeve teknike dhe sistemeve që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe funksionalitetin e infrastrukturës.

INFRAKOS-i do të synojë gjithashtu përdorimin më efikas të teknologjisë dhe mjeteve digjitale në proceset e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës, në masën që këto zgjidhje të jenë të arsyeshme teknikisht dhe financiarisht dhe të mund të mbështeten nga burimet e disponueshme.

6.3 Analiza SWOT

Analiza SWOT paraqet vlerësimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në veprimtarinë dhe zhvillimin e INFRAKOS-it gjatë vitit 2027. Përmes kësaj analize identifikohen përparësitë dhe dobësitë e kompanisë, si dhe mundësitë dhe rreziqet që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit.

Fuqitë (Përparësitë)	*Dobësitë (Mangësitë)*
→ I vetmi operator i cili ofron qasje në binarë; → Lidhja me binarë industrialë në pjesën më të madhe të minierave në Kosovë; → Ofrimi i shërbimeve të terminalit për ngarkim shkarkimin e mallrave; → Linja 10 paraqet lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve të rajonit; → Kapacitetet ekzistuese të infrastrukturës mundësojnë përfshirjen e operatorëve të tjerë të transportit;Eksperienca e gjatë në këtë biznes; → Përvojë e gjatë në menaxhimin e infrastrukturës hekurudhore; Shfrytëzimi i patundshmërive përmes dhënies me qira.	→ Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore; → Mosfunksionimi i linjave hekurudhore Prishtinë–Podujevë dhe Klinë–Prizren; → Kostoja e lartë e mirëmbajtjes së infrastrukturës hekurudhore; → Mungesa e sistemeve sinjalizuese dhe siguruese në shumicën e linjave, me përjashtim të Linjës 10;; → Mosha e vjetër e një pjese të stafit dhe produktiviteti i ulët. → Zbatimi jo i plotë i Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare me institucionet përgjegjëse;

Mundësitë (Shanset)	*Rreziqet (Kërcënimet)*
→ Lidhja e qyteteve kryesore të Kosovës dhe zhvillimi i transportit hekurudhor; → Lidhja me vendet e rajonit përmes Linjës 10 dhe Linjës 7; → Rehabilitimi dhe vënia në funksion e linjave të tjera hekurudhore; → Mundësia për shtimin e operatorëve të transportit; → Lidhja hekurudhore me Portin e Durrësit.	→ Funksionimi jo i mirë i operatorëve hekurudhorë Trainkos dhe Railtrans; → Mosfinancimi i plotë i Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare ndërmjet INFRAKOS-it dhe Qeverisë; → Mosfunksionimi i pjesës veriore të linjës Mitrovicë–kufiri me Serbinë; → Kostoja e lartë e investimeve në mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e linjave jashtë funksionit; Ndryshimet e politikave të BE-së dhe qasja e institucioneve financiare e zhvillimore ndaj investimeve hekurudhore në Ballkanin Perëndimor.



Plani i të hyrave dhe shpenzimet

KAPITULLI VII – ANALIZA STRATEGJIKE DHE FINANCIARE

7.1 Analiza financiare, të hyrat dhe financimi

Analiza financiare për vitin 2027 do të fokusohet në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të INFRAKOS-it, rritjen e nivelit të inkasimit, menaxhimin racional të shpenzimeve dhe sigurimin e burimeve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës. Të hyrat kryesore do të planifikohen nga qasja në rrjet, shfrytëzimi i patundshmërisë, shërbimet e tjera dhe financimi/subvencionimi publik, në përputhje me legjislacionin dhe marrëveshjet në fuqi.

Menaxhimi i të hyrave do të shoqërohet me masa për përmirësimin e kontraktimit, faturimit, inkasimit dhe menaxhimit të borxheve, me synim rritjen e likuiditetit dhe përdorimin sa më efikas të aseteve të kompanisë.

Për vitin 2027, të hyrat operative planifikohen në shumën prej 4,013,800.00 €, me rritje prej 654,083.46 €, ose 19.47%, krahasuar me realizimin e vitit 2026, prej 3,359,716.54 €.
Shpenzimet operative planifikohen në shumën prej 3,892,703.00 €, me rritje prej 761,232.59 €, ose 24.31%, krahasuar me realizimin e vitit 2026, prej 3,131,470.41 €.

Bazuar në këto projeksione, për vitin 2027 planifikohet rezultat financiar pozitiv prej 121,097.00 €, që përfaqëson rreth 3.02% të të hyrave operative të planifikuara. Këto projeksione synojnë ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare, kontrollin e shpenzimeve dhe përmirësimin e performancës operative të Ndërmarrjes.

Struktura e të hyrave të ndërmarrës përfshinë te hyrat nga qasja në binarë, te hyrat nga qiraj, te hyrat tjera dhe subvencionimi nga aksionari.

- **Të hyrat pagesat e qasjes në binarë (transporti mallrave dhe udhëtarve) ku edhe për vitin** 2027, INFRAKOS-i do të zbatojë Ekspozën e Rrjetit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e aplikueshme për sektorin hekurudhor. Pagesat për qasje në rrjet do të përcaktohen në përputhje me kostot dhe mekanizmat e përcaktuar me legjislacionin dhe aktet përkatëse.
- **Të hyrat nga qiraja vazhdojnë** të përbëjnë një burim të rëndësishëm për mbështetjen e likuiditetit të kompanisë. Gjatë vitit 2027 do të vazhdojë menaxhimi më efikas i patundshmërive, përmirësimi i inkasimit dhe shfrytëzimi racional i kapaciteteve ekzistuese të pronës së kompanisë.
- **Të hyrat tjera paraqesin një** kategori te të hyrave ku përfshihen të hyrat nga terminali i mallrave, mirëmbajtja e binarëve industrialë për kompanitë private dhe shërbimet e tjera që mund të ofrohen për palët e treta, përfshirë edhe të hyrat nga shitja e materialeve të panevojshme të demontuara nga linjat hekurudhor.
- **Të hyrat nga aksionari** (subvencionimi) paraqet një katrgori me të cilat mbulohet pjesërisht kosto e direkte dhe indirekte e mirëmbajtjes së linjave hekurdhore dhe operimit në përputhje me detyrimet ligjore që dalin nga legjislacioni primar dhe sekondar i aplikushem për hekurudha, si derivat e kompensimit të diferencës së tarifave të qasjes në rrjet që aprovohen nga MIT.

7.2 Shpenzimet

Menaxhimi i shpenzimeve gjatë vitit 2027 do të orientohet drejt përdorimit racional dhe efikas të burimeve financiare, duke ruajtur njëkohësisht kapacitetet e nevojshme për mirëmbajtjen, sigurinë dhe funksionimin e rregullt të infrastrukturës hekurudhore.

Shpenzimet e kompanisë përfshijnë shpenzimet për pajisje, pjesë rezervë, mjete pune, materiale shpenzuese, riparime, mirëmbajtje etj, të cilat janë evidentuar në planin e prokurimit te publikuar ne platformen e e-prokurimit perkatsisht në linkun: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx. INFRAKOS-i do të synojë kontrollin e vazhdueshëm të shpenzimeve dhe orientimin e tyre drejt prioriteteve të përcaktuara në këtë Plan të Biznesit. Çdo shpenzim do të trajtohet në përputhje me buxhetin e miratuar, në nevojat reale të kompanisë në momentin kur duhet të ndodh shpenzimi dhe kërkesat për funksionim të sigurt e efikas.

Nr	Përshkrimi	Realizimi parashikuar 2026	2026 Buxheti Planifikuar	2027 Buxheti Planifikuar
1	Gjithsejtë të hyrat	3,359,716.54	**3,753,200.00**	**4,013,800.00**
2	Gjithsejtë shpenzimet	3,131,470.41	**3,485,866.00**	**3,892,703.00**
Rezultati Neto		228,246.13	**267,334.00**	**121,097.00**

Përmbledhja e rezultateve financiare dhe burimeve të financimit për vitin 2027.

7.3 Analiza e riskut financiar dhe operacional

Realizimi i objektivave të INFRAKOS-it kërkon përcaktim të qartë të përgjegjësive, planifikim të aktiviteteve dhe mekanizma efektivë të kontrollit. Mosrealizimi i detyrave të planifikuara mund të ndikojë në realizimin e të hyrave, në funksionimin financiar të kompanisë dhe në përmbushjen e objektivave të saj.

Për këtë arsye, menaxhmenti dhe njësitë organizative përgjegjëse do të zbatojnë planet përkatëse të veprimit dhe mekanizmat e kontrollit, duke përcaktuar përgjegjësi të qarta dhe duke monitoruar realizimin e tyre gjatë vitit 2027.

Në veçanti, mosrealizimi i objektivave në fushën e mirëmbajtjes së linjave hekurudhore, sistemeve sinjalizuese, telekomunikuese dhe energjetike, komunikacionit dhe menaxhimit të patundshmërive mund të ndikojë në realizimin e të hyrave të planifikuara dhe në sigurinë e qarkullimit hekurudhor.

Një faktor i rëndësishëm për menaxhimin e riskut financiar dhe operacional mbetet zbatimi i Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare ndërmjet INFRAKOS-it dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës. Sigurimi i financimit të paparë është i rëndësishëm për funksionimin e rregullt të kompanisë dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për mirëmbajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës hekurudhore.

INFRAKOS-i do të vazhdojë të identifikojë, vlerësojë dhe trajtojë rreziqet financiare dhe operative në përputhje me përgjegjësitë e njësive organizative dhe mekanizmat e kontrollit të brendshëm.

7.4 Monitorimi i realizimit dhe kontributi në arritjen e objektivave

Gjatë vitit 2027, menaxhmenti dhe të gjitha njësitë organizative të INFRAKOS-it do të kenë përgjegjësi të qarta në realizimin e objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit.


Kontributi i njësive operative do të fokusohet veçanërisht në mirëmbajtjen e linjave hekurudhore, pajisjeve sinjalizuese, telekomunikuese dhe energjetike, si dhe në organizimin e sigurt të qarkullimit të trenave. Njësitë mbështetëse do të kontribuojnë përmes menaxhimit të burimeve njerëzore, financave, prokurimit, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse.




Monitorimi i performancës do të bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes mekanizmave ekzistues të kontrollit dhe raportimit. Të dhënat e monitorimit do të përdoren për vlerësimin e nivelit të realizimit të objektivave, identifikimin e devijimeve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese kur është e nevojshme.

Gjatë vitit 2027, mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit do të rishikohen dhe përmirësohen me qëllim forcimin e përgjegjësisë, llogaridhënies dhe performancës së të gjitha niveleve organizative të INFRAKOS-it.

Projeksionet financiare për vitin 2027 paraqesin një kornizë të qëndrueshme dhe të kujdesshme të menaxhimit financiar, e cila synon të sigurojë vazhdimësinë e veprimtarisë, stabilitetin financiar dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të INFRAKOS Sh.A. Realizimi i objektivave financiare do të mbështetet në monitorimin e vazhdueshëm të performancës financiare, analizimin e devijimeve nga planifikimet fillestare dhe ndërmarrjen me kohë të masave korrigjuese, sipas nevojës, me qëllim të ruajtjes së ekuilibrit financiar dhe shfrytëzimit sa më efikas të burimeve në dispozicion. Në këtë kuadër, INFRAKOS Sh.A. zbaton një politikë të kujdesshme dhe konservative të menaxhimit të shpenzimeve, duke i rivlerësuar ato në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me nevojat reale operative dhe mundësitë financiare të Ndërmarrjes. Kjo qasje ka dëshmuar rezultate pozitive, pasi realizimi i shpenzimeve në periudhat paraprake ka qenë më i ulët se planifikimet fillestare, duke reflektuar angazhimin për disiplinë buxhetore, kontroll të kostove dhe përdorim racional të mjeteve financiare. Përvoja e deritanishme dëshmon se zbatimi i kësaj politike kontribuon në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare, forcimin e kapaciteteve operacionale dhe përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të Ndërmarrjes. Në këtë drejtim, INFRAKOS Sh.A. do të vazhdojë të zbatojë praktika të përgjegjshme të menaxhimit financiar, duke synuar krijimin e një baze të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejmë institucional, përmbushjen e objektivave strategjike dhe rritjen e performancës në vitin 2027.





Rezultatet

KAPITULLI VIII – ZBATIMI DHE MONITORIMI

8.1 Programi i aktiviteteve dhe monitorimi i zbatimit

Plani i Biznesit për vitin 2027 do të zbatohet përmes planeve të punës dhe planeve të veprimit të njësive organizative të INFRAKOS-it, në përputhje me objektivat dhe prioritetet e përcaktuara në këtë dokument.

Realizimi i aktiviteteve dhe objektivave do të monitorohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit 2027, përmes raportimit periodik, përcjelljes së treguesve të performancës dhe vlerësimit të rezultateve të arritura.

Për aktivitetet që lidhen me mirëmbajtjen e infrastrukturës, sigurinë dhe funksionimin e rrjetit Aktivitetet dhe masat konkrete do të përshtaten sipas gjendjes teknike të infrastrukturës, nevojave operative, burimeve në dispozicion dhe kushteve të realizimit.

Për projektet zhvillimore dhe investimet kapitale, monitorimi do të bëhet në përputhje me dinamikën e miratuar të projekteve, kontratat përkatëse, burimet e financimit dhe kushtet teknike e financiare të zbatimit.

Në rast të devijimeve nga objektivat ose aktivitetet e planifikuara, njësitë përgjegjëse do të analizojnë shkaqet dhe do të propozojnë masat e nevojshme korrigjuese, me qëllim sigurimin e realizimit sa më të plotë të Planit të Biznesit.

8.2 Supozimet kyçe dhe kushtet e realizimit

Realizimi i Planit të Biznesit për vitin 2027 mbështetet në një numër kushtesh dhe supozimesh që lidhen me zhvillimet ekonomike, financiare, institucionale, rregullative dhe operative të sektorit hekurudhor.

- **Gjendja ekonomike dhe zhvillimi i transportit**

  Zhvillimi i transportit hekurudhor dhe niveli i shfrytëzimit të kapaciteteve të infrastrukturës ndikojnë drejtpërdrejt në të hyrat e INFRAKOS-it nga pagesat për qasje në rrjet.

  Vënia në funksion e segmenteve të rehabilituara të Linjës 10 krijon mundësi për rritjen e transportit hekurudhor dhe, rrjedhimisht, për rritjen e shfrytëzimit të kapaciteteve të infrastrukturës dhe të të hyrave të kompanisë.

- **Korniza rregullative dhe kontraktuale**

  Realizimi i objektivave të vitit 2027 varet edhe nga zhvillimi dhe zbatimi i kornizës rregullative të sektorit hekurudhor, përfshirë aktet nënligjore dhe mekanizmat që rregullojnë financimin dhe funksionimin e infrastrukturës hekurudhore.

  INFRAKOS-i do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për adresimin e çështjeve rregullative dhe financiare që ndikojnë në funksionimin dhe zhvillimin e kompanisë.

- **Financimi**

  Një nga kushtet kryesore për realizimin e Planit të Biznesit është sigurimi i burimeve të nevojshme financiare për mirëmbajtjen, sigurinë dhe zhvillimin e infrastrukturës.

  Në këtë kuadër, zbatimi i Marrëveshjes Financiare Pesëvjeçare ndërmjet INFRAKOS-it dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe sigurimi i financimit nga partnerët zhvillimorë për projektet prioritare, përbëjnë kushte të rëndësishme për realizimin e objektivave të kompanisë.

- **Zhvillimi teknologjik dhe projektet**

  Realizimi i projekteve të rehabilitimit dhe modernizimit të infrastrukturës, përfshirë Linjën 10, si dhe avancimi i projekteve për linjat Fushë Kosovë–Klinë–Pejë dhe Klinë–Prizren, do të ndikojnë në përmirësimin e kapaciteteve teknike, sigurisë dhe funksionalitetit të rrjetit.

  INFRAKOS-i do të përcjellë zhvillimin e këtyre projekteve dhe do të bashkëpunojë me institucionet dhe partnerët përkatës për krijimin e kushteve të nevojshme për realizimin e tyre.

8.3 Vlerësimi i rreziqeve

Vlerësimi i rreziqeve synon identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të Planit të Biznesit për vitin 2027 dhe përcaktimin e fushave në të cilat kërkohet vëmendje dhe menaxhim i vazhdueshëm.

- **Siguria dhe qëndrueshmëria**

Siguria dhe qëndrueshmëria përbëjnë fushën kryesore të rrezikut për kompaninë. Rreziku mund të rritet në rast të:

- mosrealizimit të mirëmbajtjes së rregullt dhe parandaluese të infrastrukturës hekurudhore;
- mosndërmarrjes së masave të nevojshme për parandalimin e dëmtimeve dhe vjedhjeve të infrastrukturës nga palët e treta;
- mosadresimit në kohë të rreziqeve që lidhen me vendkalimet rrugë–hekurudhë.

Këta faktorë mund të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit hekurudhor.

- **Menaxhimi i aseteve, kapaciteteve dhe projekteve**

Menaxhimi i aseteve, kapaciteteve të infrastrukturës dhe projekteve kapitale përbën një fushë tjetër të rëndësishme të menaxhimit të rrezikut.

Rreziqet kryesore lidhen me:

- përmirësimet e pamjaftueshme në menaxhimin e aseteve;
- vonesat në përditësimin dhe sistemimin e bazës së të dhënave të aseteve;
- mosbalancimin ndërmjet performancës, kapaciteteve dhe kostove;
- realizimin jo të plotë ose me vonesa të projekteve;
- bashkëpunimin joefektiv me palët e interesit;
- mosrealizimin e detyrave dhe objektivave të përcaktuara në Planin e Biznesit. INF

➢ **Teknologjia, organizimi dhe burimet njerëzore**

Realizimi i objektivave të vitit 2027 varet edhe nga kapacitetet teknologjike, organizative dhe profesionale të kompanisë.

Në këtë fushë, rreziqet kryesore lidhen me:

- mungesën e përmirësimit të komunikimit dhe koordinimit;
- vonesat ose mungesën e përmirësimeve teknologjike;
- mosrealizimin e përmirësimeve të nevojshme në strukturën organizative;
- mungesën e stafit me kompetenca të nevojshme profesionale;
- sigurimin e pamjaftueshëm të financimit publik;
- pamundësinë e përshtatjes së menaxhmentit dhe strukturave organizative me ndryshimet dhe transformimet e sistemit hekurudhor.

INFRAKOS-i do t'i trajtojë këto rreziqe përmes monitorimit të vazhdueshëm, përcaktimit të përgjegjësive, raportimit dhe ndërmarrjes së masave parandaluese dhe korrigjuese në përputhje me natyrën dhe nivelin e secilit rrezik.

Struktura, kapacitetet njerëzore

KAPITULLI IX – BURIMET NJERËZORE

9.1 Struktura organizative e kompanisë

Struktura organizative e INFRAKOS-it është e orientuar drejt përmbushjes së funksioneve kryesore të kompanisë dhe sigurimit të një ndarjeje të qartë të përgjegjësive në menaxhimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore.

Për vitin 2027, INFRAKOS-i do të fokusohet në funksionalizimin sa më efikas të strukturës ekzistuese, përmirësimin e koordinimit ndërmjet njësive organizative dhe forcimin e përgjegjësisë në ushtrimin e detyrave dhe funksioneve.

Në varësi të zhvillimit të veprimtarisë së kompanisë, ndryshimeve teknologjike, kërkesave operative dhe mundësive financiare, do të vlerësohen nevojat për përshtatjen e strukturës organizative dhe proceseve të punës si dhe nevojen per punsime të reja.

Çdo ndryshim eventual organizativ do të trajtohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet e brendshme të kompanisë dhe nevojat reale të INFRAKOS-it, duke synuar rritjen e efikasitetit, qartësimin e përgjegjësive dhe forcimin e llogaridhënies.

9.2 Resurset njerëzore dhe planifikimi afatgjatë

Resurset njerëzore përbëjnë një nga komponentët kryesorë për realizimin e objektivave të INFRAKOS-it. Përvoja profesionale dhe njohuritë e stafit janë veçanërisht të rëndësishme për një kompani që ushtron veprimtari të specializuar në menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore.

Për vitin 2027, politika e burimeve njerëzore do të orientohet në ruajtjen dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale, ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve dhe sigurimin e personelit të nevojshëm për funksionet kryesore të kompanisë.

INFRAKOS-i do të vazhdojë me zhvillimin profesional të punonjësve përmes trajnimeve, aftësimit të vazhdueshëm dhe formave të tjera të zhvillimit profesional, në përputhje me kërkesat e vendeve të punës dhe specifikat e veprimtarisë hekurudhore. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet trajnimeve që lidhen me sigurinë, mirëmbajtjen e infrastrukturës, përdorimin e pajisjeve dhe teknologjive të reja, si dhe me kërkesat profesionale të funksioneve përkatëse.

Një sfidë e rëndësishme për kompaninë mbetet struktura e moshës së punonjësve dhe nevoja për ruajtjen dhe transferimin e njohurive profesionale. Në këtë drejtim, INFRAKOS-i do të synojë shfrytëzimin e përvojës së stafit ekzistues dhe transferimin gradual të njohurive te gjeneratat e reja të punonjësve.

Planifikimi afatgjatë i burimeve njerëzore do të lidhet me zhvillimin dhe modernizimin e infrastrukturës hekurudhore, nevojat për funksionet kritike dhe kapacitetet financiare të kompanisë. Në përputhje me këto nevoja, do të vlerësohet edhe mundësia e angazhimit të stafit të ri në pozitat ku ekziston nevojë e arsyeshme funksionale dhe profesionale.

INFRAKOS-i do të vazhdojë të ketë në fokus edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për punë, mbrojtjen dhe sigurinë në vendin e punës, si dhe mirëqenien e punonjësve, në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse.

Qëllimi i planifikimit të burimeve njerëzore është krijimi i një strukture profesionale, të qëndrueshme dhe funksionale, e aftë për të përballuar nevojat aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të INFRAKOS-it.

9.3 Politikat e punësimit


Politika e punësimit për vitin 2027 do të bazohet në nevojat reale të kompanisë, mundësitë financiare dhe kërkesat profesionale të funksioneve të saj.

INFRAKOS-i do të synojë ruajtjen e kapaciteteve ekzistuese profesionale dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme për funksionimin efikas të kompanisë. Rekrutimi i stafit të ri do të shqyrtohet në rastet kur paraqiten nevoja të arsyetuara për funksione profesionale, teknike, financiare, të burimeve njerëzore, inxhinierike apo për pozita të tjera që janë të rëndësishme për realizimin e objektivave të kompanisë.

Në veçanti, nevojat për punësim do të vlerësohen në raport me plotësimin e vendeve të punës të domosdoshme, zëvendësimin gradual të stafit që përfundon marrëdhënien e punës dhe sigurimin e kapaciteteve profesionale për funksionet që kërkojnë ekspertizë të specializuar.

Punësimi do të realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet e brendshme të kompanisë, parimet e transparencës dhe kriteret profesionale.

Në planifikimin e punësimit do të merret parasysh edhe dinamika e rehabilitimit dhe modernizimit të linjave hekurudhore. Rritja e kapaciteteve të stafit do të harmonizohet me nevojat që krijohen nga funksionalizimi i infrastrukturës së rehabilituar dhe zhvillimi i aktiviteteve të reja të kompanisë.



E ardhmja dhe sfidat

KAPITULLI X – PERSPEKTIVA AFATGJATË DHE SFIDAT

10.1 Rëndësia strategjike e transportit hekurudhor

Transporti hekurudhor paraqet një komponent të rëndësishëm të zhvillimit të sistemit të transportit në Republikën e Kosovës dhe një alternativë të qëndrueshme ndaj transportit rrugor. Zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore krijon mundësi për rritjen e kapaciteteve të transportit të udhëtarëve dhe mallrave, përmirësimin e lidhjeve ndërmjet qendrave kryesore dhe forcimin e lidhjeve rajonale.

Në këtë kuadër, INFRAKOS-i do të vazhdojë të orientojë aktivitetet e tij drejt përmirësimit të performancës së kompanisë, uljes dhe menaxhimit racional të kostove, ngritjes së kompetencave profesionale, menaxhimit më efikas të aseteve dhe përmirësimit të planifikimit të kapaciteteve të infrastrukturës.

Një rëndësi të veçantë do të ketë rehabilitimi dhe modernizimi i Linjës 10, si dhe zhvillimi i projekteve të tjera të infrastrukturës hekurudhore. Përfundimi dhe funksionalizimi i segmenteve të rehabilituara pritet të krijojë kushte për rritjen e përdorimit të rrjetit dhe përmirësimin e shërbimeve infrastrukturore.

INFRAKOS-i do të vazhdojë bashkëpunimin me institucionet vendore, operatorët hekurudhorë, partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet financiare zhvillimore, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme për investimet në infrastrukturën hekurudhore.

Në perspektivën afatgjatë, zhvillimi i kompanisë do të mbështetet në rritjen e sigurisë, modernizimin e infrastrukturës, përdorimin më efikas të kapaciteteve ekzistuese, përmirësimin e qëndrueshmërisë financiare dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale.

10.2 Sfidat kryesore të ndërmarrjes gjatë vitit 2027

Gjatë hartimit të Planit të Biznesit për vitin 2027, menaxhmenti i INFRAKOS Sh.A. ka identifikuar sfidat dhe rreziqet kryesore që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të planifikuara, në performancën financiare dhe operative, si dhe në zhvillimin e mëtejmë të infrastrukturës hekurudhore. Këto sfida lidhen kryesisht me shfrytëzimin e kapaciteteve ekzistuese, sigurimin e financimit të qëndrueshëm, realizimin e projekteve infrastrukturore, si dhe me mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e aseteve të ndërmarrjes.
Përballja me këto vështirësi kërkon planifikim të kujdesshëm, menaxhim efikas të burimeve në dispozicion dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse dhe operatorët hekurudhorë. Në këtë drejtim, sfidat kryesore që pritet të vazhdojnë të ndikojnë në veprimtarinë e ndërmarrjes gjatë vitit 2027 janë si në vijim:

1. Shfrytëzimi jo i plotë i kapaciteteve të infrastrukturës hekurudhore

Shfrytëzimi jo i plotë i linjave hekurudhore funksionale për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave mbetet një nga sfidat që ndikon drejtpërdrejt në nivelin e të hyrave dhe në efikasitetin e shfrytëzimit të infrastrukturës hekurudhore. Përdorimi i kufizuar i kapaciteteve ekzistuese nga operatorët hekurudhorë ndikon në realizimin e potencialit ekonomik të rrjetit dhe në mundësitë për rritjen e të hyrave nga shërbimet e qasjes në infrastrukturë. Për këtë arsye, rritja e shfrytëzimit të linjave funksionale dhe avancimi i bashkëpunimit me operatorët hekurudhorë mbeten faktorë të rëndësishëm për përmirësimin e performancës së ndërmarrjes.
2. Mbulimi i diferencës së pagesave për qasje në rrjetin hekurudhor

Subvencionimi i pjesshëm i diferencës ndërmjet pagesave për qasje në rrjetin hekurudhor dhe kostove përkatëse përbën një sfidë për qëndrueshmërinë financiare të INFRAKOS Sh.A. Mbulimi jo i plotë i kësaj diference mund të krijojë vështirësi në financimin e kostove operative, mirëmbajtjen e rregullt të infrastrukturës dhe përmbushjen e obligimeve financiare të ndërmarrjes. Në këtë kontekst, sigurimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm të financimit mbetet i rëndësishëm për krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin dhe funksionimin e qëndrueshëm të ndërmarrjes.

3. Vonesat në realizimin e projektit të Linjës së 10-të hekurudhore

Realizimi i projektit të Linjës së 10-të hekurudhore paraqet një nga proceset e rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës hekurudhore. Vonesat e mundshme dhe vështirësitë gjatë fazave të realizimit të projektit mund të ndikojnë në dinamikën e zbatimit, afatet e planifikuara dhe arritjen e objektivave zhvillimore. Për këtë arsye, koordinimi ndërmjet akterëve përgjegjës, përcjellja e vazhdueshme e progresit dhe adresimi me kohë i çështjeve që mund të pengojnë realizimin e projektit janë të rëndësishme për avancimin e tij.

4. Sigurimi i financimit për projektet zhvillimore të ndërmarrjes

Sigurimi i burimeve të nevojshme financiare për realizimin e projekteve zhvillimore mbetet një nga sfidat kryesore të INFRAKOS Sh.A. Mungesa e financimit të mjaftueshëm dhe të parashikueshëm mund të kufizojë realizimin e investimeve prioritare, modernizimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e kushteve të operimit. Në këtë drejtim, lidhja e marrëveshjeve financiare shumëvjeçare dhe sigurimi i mbështetjes përmes mekanizmave përkatës institucionalë janë të rëndësishme për planifikimin afatgjatë, përcaktimin e prioriteteve investuese dhe rritjen e kapaciteteve zhvillimore të ndërmarrjes.

5. Kostot e larta të rehabilitimit të linjave hekurudhore jashtë funksionit

Rehabilitimi i linjave hekurudhore që aktualisht janë jashtë funksionit kërkon investime të konsiderueshme financiare, teknike dhe materiale. Kostoja e lartë e ndërhyrjeve infrastrukturore, e kombinuar me nevojën për prioritizimin e investimeve sipas rëndësisë dhe mundësive financiare, mund të ndikojë në dinamikën e rikthimit të këtyre linjave në funksion. Si rrjedhojë, identifikimi i prioriteteve, vlerësimi i nevojave për rehabilitim dhe sigurimi i burimeve të financimit janë thelbësore për planifikimin gradual të ndërhyrjeve dhe zgjerimin e kapaciteteve funksionale të rrjetit hekurudhor.

6. Mbrojtja e pronës dhe e infrastrukturës hekurudhore

Dëmtimi i pronës së ndërmarrjes, ndërhyrjet e paautorizuara në asetet infrastrukturore dhe hapja e vendkalimeve ilegale hekurudhore vazhdojnë të paraqesin sfida për sigurinë dhe integritetin e infrastrukturës hekurudhore. Këto veprime mund të shkaktojnë dëme materiale, të rrisin kostot e mirëmbajtjes dhe të krijojnë rreziqe për sigurinë e qarkullimit hekurudhor dhe të pjesëmarrësve në trafik. Përballja me këtë problem kërkon forcimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së pronës, identifikimin dhe parandalimin e ndërhyrjeve të paautorizuara, si dhe bashkëpunimin me institucionet kompetente për trajtimin e rasteve të evidentuara.

Masat dhe orientimet për adresimin e sfidave

Për adresimin e sfidave të identifikuara, gjatë vitit 2027 menaxhmenti i INFRAKOS Sh.A. do të fokusohet në përmirësimin e menaxhimit të kapaciteteve ekzistuese, avancimin e bashkëpunimit me operatorët hekurudhorë dhe institucionet përgjegjëse, si dhe në krijimin e kushteve për financim të

qëndrueshëm të veprimtarisë dhe projekteve zhvillimore. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet avancimit të procesit për sigurimin e financimit shumëvjeçar, përcjelljes së realizimit të projekteve infrastrukturore dhe përcaktimit të prioriteteve për rehabilitimin e linjave jashtë funksionit.
Njëkohësisht, ndërmarrja do të angazhohet në forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e pronës dhe infrastrukturës hekurudhore, me qëllim të zvogëlimit të dëmeve dhe rreziqeve që ndikojnë në sigurinë dhe funksionalitetin e rrjetit.
Realizimi i këtyre orientimeve do të varet nga koordinimi ndërmjet strukturave të brendshme të ndërmarrjes dhe institucioneve të tjera përgjegjëse, si dhe nga sigurimi i mbështetjes së nevojshme financiare dhe institucionale. Për rrjedhojë, menaxhimi i sfidave të identifikuara do të jetë pjesë e rëndësishme e angazhimeve të menaxhmentit gjatë vitit 2027, me synim përmirësimin e performancës, rritjen e qëndrueshmërisë financiare dhe krijimin e kushteve për zhvillimin afatgjatë të INFRAKOS Sh.A.

10.3 Perspektiva e zhvillimit të rrjetit hekurudhor

Rritja e vazhdueshme e ngarkesës së transportit rrugor dhe nevoja për alternativa më të sigurta dhe më të qëndrueshme e rrisin rëndësinë strategjike të zhvillimit të transportit hekurudhor.

Rrjeti hekurudhor i Kosovës ofron potencial për lidhjen e shumicës së qendrave kryesore urbane dhe për zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe mallrave. Përmes rehabilitimit dhe modernizimit të linjave ekzistuese, krijohen mundësi për rritjen e përdorimit të kapaciteteve hekurudhore dhe për transferimin gradual të një pjese të transportit nga rruga në hekurudhë.

Zhvillimi i transportit hekurudhor mund të kontribuojë në zvogëlimin e ngarkesës së trafikut rrugor, uljen e numrit të aksidenteve dhe kostove të mirëmbajtjes së rrugëve, si dhe në reduktimin e ndikimeve negative në mjedis.

Në perspektivën rajonale, rehabilitimi dhe zhvillimi i Linjës 10 dhe lidhjeve të tjera hekurudhore krijon mundësi për përmirësimin e lidhjeve të Kosovës me vendet e rajonit dhe integrimin më të madh të rrjetit hekurudhor në korridoret rajonale dhe evropiane.

Në këtë drejtim, mbështetja e institucioneve të Bashkimit Evropian, BERZH-it, BEI-së dhe partnerëve të tjerë zhvillimorë paraqet një mundësi të rëndësishme për financimin dhe realizimin e projekteve prioritare të infrastrukturës.

Përveç Linjës 10, perspektiva e zhvillimit përfshin edhe avancimin e projekteve për linjat Fushë Kosovë–Klinë–Pejë dhe Klinë–Prizren, **linjën "Bardh i Madh – Aeroport"** si dhe shqyrtimin dhe zhvillimin e projekteve të tjera që mund të kontribuojnë në zgjerimin dhe funksionalizimin e rrjetit hekurudhor dhe mirëmbajtjen e tij, të cilat projekte janë dërguar per shqyrtim në ministritë e linjave.

INFRAKOS-i do të vazhdojë të punojë në identifikimin e nevojave për investime, përgatitjen dhe avancimin e projekteve, si dhe në bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për sigurimin e financimit të nevojshëm.

Perspektiva afatgjatë e kompanisë është ndërtimi i një rrjeti hekurudhor më të sigurt, funksional, modern dhe të qëndrueshëm, i cili do të mundësojë shfrytëzim më të madh të kapaciteteve të infrastrukturës dhe do të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor të Republikës së Kosovës.

KAPITULLI XI – DISPOZITA PËRFUNDIMTARE DHE MIRATIMI

Plani i Biznesit për vitin 2027, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Bordi i Drejtorëve, përbën dokumentin bazë për orientimin e veprimtarisë së INFRAKOS-it gjatë periudhës përkatëse. Realizimi i tij do të përcillet përmes mekanizmave të raportimit, kontrollit të brendshëm dhe monitorimit të objektivave, ndërsa çdo rishikim eventual do të bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe vendimet e organeve kompetente.

Për miratim: Bordi i Drejtorëve i INFRAKOS-it

Vendimi nr 2/87 me datë 30 /10/2026